

Përmbledhje e VNM “AKUAKULTURE INTENSIVE”

(Per konsultimin me publikun)

SUBJEKTI: “GJIKONDI” shpk

**VENDODHJA E OBJEKTIT: “Fiku i Polimerit” , Gjiri i Palermos, Himare,
Vlore**

PRILL, 2017

1

Ing PETRIT DERVISHI
EKSPERT
V.N.M. & A.MJEDISO
VLORE



PËRMBAJTJA

QËLLIMI I HARTIMIT TË VNM	4
Qëllimi i aktivitetit.....	4
Legjislacioni i konsultuar per realizimin e VNM	4
PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I INSTALIMIT	5
Vendndodhja ku ushtrohet aktiviteti	5
Të dhëna mbi llojet e peshkut që do të kultivohet	5
Koca (Sparus aurata)	5
Levreku (Dicentrarchus labrax).....	6
Përshkrim i projektit teknik.....	6
Impianti në det.....	6
Rasati dhe ushqimi.....	7
Magazina.....	7
Fuqia punëtore.....	7
PËRSHKRIMI I MJEDISIT FIZIK NË ZONË.....	8
Pozicioni gjeografik dhe relievi	8
Klima	8
Gjeologjia	8
Hidrografia	9
Tokat	9
BIODIVERSITETI	10
Flora	10
Fauna.....	10
Mjedisi detar	10
Cilësia e ujërave bregdetarë	11
Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës.....	11
VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS TË INSTALIMIT	11

Metodika e vlerësimit të ndikimeve	11
Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis në fazën e instalimit të impiantit	12
Identifikimi i ndikimeve negative gjatë zhvillimit të aktivitetit.....	12
MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS	12

QËLLIMI I HARTIMIT TË VNM

Qëllimi i aktivitetit

Përmes projektit të paraqitur shoqëria “Gjikondi” sh.p.k. synon zhvillimin e akuakulturës në Gjirin e Palermos, Himarë, në vendin e quajtur “Fiku i Polimerit”. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është kultivimi i llojeve të koces (*Sparus aurata*) dhe levrekut (*Dicentrarchus labrax*) me kosha notues në det të hapur. Shoqëria ka planifikuar të vendosë 18 kosha notues në det në një sipërfaqe prej 3.5 ha dhe të ndërtojë një magazinë në anë të rrugës nacionale Vlorë-Sarandë, në afërsi të Porto Palermos. Magazina do të jetë një ndërtesë njëkatëshe me sipërfaqe rreth 70m².

Legjislacioni i konsultuar për realizimin e VNM

Për realizimin e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë së propozuar u konsultuan dokumente mjedisore që lidhen me politikat shtetërore të mbrojtjes së mjedisit, zonës në të cilën propozohet të zhvillohet dhe legjislacionit që rregullon zhvillimin e peshkimit e akuakulturës.

Përgatitja e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të aktivitetit të propozuar është kryer duke u bazuar në aktet ligjorë të mëposhtëm:

- Ligj nr.8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” me ndryshimet përkatëse,;
- Ligj nr.8990 datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” me ndryshimet përkatëse;
- Udhëzim nr.6 datë 27.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie”;
- VKM nr.805 datë 04.12.2003 “Për miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore”;
- Ligj nr.7908 datë 05.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, me ndryshimet përkatëse,;
- Ligj nr. 8905 datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”;
- Rregullore nr.1 datë 29.03.2005 “Për zbatimin e Ligjshmërisë në Peshkim dhe Akuakulturë”;
- Ligj nr.9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”;
- Ligj nr.8906 datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”;
- Ligj nr.9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”;
- Ligj nr.8094 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”;

- Ligji nr.9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”;
- VKM nr.994 datë 02.07.2008 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin” i cili përcakton përgjegjësitë e zhvilluesit të veprimtarisë dhe organeve shtetërore për përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore;
- VKM nr.676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”;
- Rregullore nr.1 datë 15.03.2006 “Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis të veprimtarive ndërtimore”;
- Rregullore nr.1 datë 30.03.2007 “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre”;
- Udhëzim nr.5 datë 28.12.2007 “Për tarifën e shërbimit për lejet mjedisore”;
- Udhëzim nr.2 datë 29.06.2010 “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”.

PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I INSTALIMIT

Vendndodhja ku ushtrohet aktiviteti

Aktiviteti i akuakulturës zhvillohet në bregdetin jugor të Shqipërisë, në zonën ndërmjet Himarës dhe Qeparoit, në Gjirin e Palermos, në vendin e quajtur “Fiku i Polimerit”, dhe ndodhet rreth 1 km në juglindje të gadishullit ku ndodhet kështjella e Ali Pashë Tepelenës dhe 300-350 m nga bregu i detit.

Ndërsa godina që shërben si magazinë dhe zyrë e shoqërisë ngrihet në anë të rrugës automobilistike Himarë-Borsh, pothuaj në të njëjtën largësi nga gadishulli. Zona e propozuar për zhvillimin e projektit të akuakulturës përfshihet në planshetin topografik K-34-136-D-c (Borshi) të shkallës 1:25000.

Të dhëna mbi llojet e peshkut që do të kultivohet

Qëllimi i aktivitetit është kultivimi me kosha notues në det të hapur i llojeve të kocës (*Sparus aurata*) dhe levrekut (*Dicentrarchus labrax*). Arsyeja kryesore e përzgjedhjes së këtyre dy llojeve është sepse ujërat e detit Jon mbështesin natyrisht jetesën e tyre me resurset e nevojshme. Nga ana tjetër të dy këta lloje janë tepër të kërkuar në treg duke garantuar kështu leverdisshmërinë ekonomike të zhvillimit të aktivitetit.

Kërkesa e tregut për këta lloje të peshkut është bërë shkak për një zhvillim të vrullshëm të këtij aktiviteti, duke rritur njëkohësisht edhe njohuritë e nevojshme mbi teknologjitë e kultivimit të tyre.

Koca (*Sparus aurata*)

Koca bën pjesë në llojet shumë të vlerësuara si ushqim dhe për këtë arsye kultivimi i saj është i zhvilluar pothuaj në të gjithë pellgun e Mesdheut. Duke qenë se popullata e kocës në gjendje natyrore është tepër e

vogël krahasuar me kërkesën e saj në treg, zhvillohet aktiviteti i akuakulturës i cili siguron plotësimin e nevojave për ushqim dhe siguron ruajtjen e llojit në gjendje natyrore.

Në pikpamje gjeografike koca takohet në ujërat e Detit Mesdhe, në ujërat që lagin Britaninë e Madhe dhe Senegalin, ishujt Kanarie dhe ata të Kepit Verde. Ky lloj peshku preferon shtratet barishtore ose ranore të fundit të detit. Ai kategorizohet si peshk vetmitar ose që jeton në grupe tepër të vogla. Peshku i kocës arrin maksimumin e përmasave të tij trupore në gjatësinë 70 cm, por në pjesën më të madhe individët nuk e kalojnë gjatësinë prej 35 cm. Pështa trupore e tij në raste të rralla mund të arrijë deri në 16 kg, por mesatarisht luhetat deri në 2 kg. Peshku maturohet për riprodhim mbas vitit të parë të jetës kur ka arritur një gjatësi mesatare prej 25 cm dhe ndryshon seksin. Larva zhvillohet në zonën e planktonikut me një periudhë larvare që shkon deri në 50 ditë në temperaturë të ujit rreth 17- 18°C. Dieta e kocës përbëhet kryesisht nga invertebrorë dhe ndonjëherë nga bimësia apo organizmat planktonike. Më së shumti kocet preferojnë butakët si midhjet.

Levrek (Dicentrarchus labrax)

Levrek njihet edhe si peshku i sportit për shkak të karakterit të tij luftarak. Ai përfaqëson një lloj me rëndësi unike komerciale dhe sportive në Europë dhe për këtë shkak ekziston një treg ndërkombëtar i tij, në të cilin vlerësohet me çmim shumë të lartë. Ky fakt e bën atë tepër të rëndësishëm ekonomikisht. Levrek konsiderohet peshk i madh që mund të arrijë gjatësinë prej 1 m. Pështa trupore e tij në varësi edhe të seksit dhe moshës mund të arrijë masën e 10 kg. Trupi i peshkut është i mbuluar me luspa të rregullta, ngjyra e të cilave ndryshon nga gri e errët në blu ose të gjelbër dhe në bark e verdhë. Levrek riprodhohet me pllenim të jashtëm. Vezët i lëshon nga shkurti në korrik në ujëra, temperaturat e të cilave luhaten 8- 15°C.

Përshkrim i projektit teknik

Projekti teknik mund të konsiderohet në dy njësi:

- Impianti i kultivimit të peshqve në det – zona e vendosjes së koshave notues,
- Godina që shërben si magazinë dhe zyrë.

Impianti në det

Shoqëria ka instaluar në një sipërfaqe ujore prej 3.5 ha në zonën e percaktuar për zhvillimin e këtij aktiviteti 18 kosha notues, të formës rrethore dhe katrore. Koshat në formë katrore kanë përmasa 6m x 6m x 10 m (gjerësi x gjatësi x lartësi), ndërsa ata në formë rrethore Ø=6 m dhe lartësi 10 m. Volumi i secilit kosh është rreth 500 m³.

Rasati dhe ushqimi

Në një m³ të koshit mund të hidhen 40 copë rasate që do të thotë se në një kosh me volum 500 m³ do të hidhen 20,000 copë rasate. Rasati që do të përdoret për të dy llojet e peshkut blihet në Itali dhe do të përmbushë të gjithë standartet dhe direktivat e Bashkimit Europian për të. Transporti i tij do të kryhet me mjetet e posaçme frigoriferike që përbën edhe një nga kushtet teknike bazë të transportit.

Gjithashtu edhe ushqimi blihet në Itali. Llogaritja e nevojës për ushqim bëhet në bazë të moshës së rasatit dhe intensitetit të rritjes në periudha të ndryshme të vitit. Ushqimi do t'u serviret peshqve çdo ditë bazuar në dietat e çdo lloji peshku dhe specifikat e tjera. Sasia e ushqimit të servirur çdo ditë në çdo kosh gjatë periudhës së rritjes do të përcaktohet saktësisht në programin e ushqimit ditor. Programi i ushqimit të peshqve varet nga numri i individeve dhe pesha, temperatura e ujit dhe performanca termodinamike e ushqimit. Peshqit do të qëndrojnë në kosha specifike derisa të arrijnë peshën mesatare prej 30 gr. Një cikël i plotë i daljes së prodhimit zgjat mesatarisht 14 muaj. Transporti i ushqimit nga magazina për në koshat notues do të bëhet nëpërmjet një sanalli i cili do të shërbejë edhe për transportin e anasjelltë të peshkut nga koshat tek magazina.

Magazina

Pothuaj në vijë paralele me impiantin, në krah të rrugës nacionale Himarë-Borsh, ngrihet një godinë njëkatëshe e cila do të shërbejë si magazinë dhe zyrë për personelin e shoqërisë. Sipërfaqja e përgjithshme e truallit ku do të ngrihet magazina është 300 m², ndërsa sipërfaqja e ndërtimit është rreth 70 m².

Godina ka një planimetri të thjeshtë (referoju vizatimit përkatës), është njëkatëshe dhe përbëhet nga ndarja kryesore dhe më e madhja e cila do të shërbejë si magazinë për rasatin, ushqimin dhe peshkun si dhe nga një ambjent zyre dhe tualeti. Trualli ka akses të drejtpërdrejtë me rrugën nacionale nga njëra anë dhe me detin nga ana tjetër duke e bërë të lehtë qarkullimin e mjeteve të transportit. Ajo është ndërtuar me materiale të lehta.

Fuqia punëtore

Për realizimin e aktivitetit të akuakulturës, shoqëria parashikon të punësojë rreth 8 persona, me preferencë nga zonat përreth. Kjo jo vetëm për të shmangur shpenzime të tjera shtesë si transporti, por edhe sepse banorët e zonës kanë tradita në rritjen dhe kultivimin e peshkut duke qenë zonë bregdetare.

PËRSHKRIMI I MJEDISIT FIZIK NË ZONË

Pozicioni gjeografik dhe relievi

Zona ku janë instaluar koshat për kultivimin e peshqeve shtrihet në jugperëndim të vendit dhe është pjesë e Krahinës Malore Jugore. Më konkretisht ajo gjendet në krahinën e Himarës, në Gjirin e Palermos. Gjiri i Palermos ka origjinë tektonike. Pothuaj në mesin e tij gjendet një gadishull i vogël shkëmbor i cili lidhet me bregun përmes një rripi toke të ngushtë dhe të cekët.

Në pjesën veriore Gjiri i Palermos mbyllet nga një gadishull në formën e gishtit, i cili ngushton hyrjen e tij. Në pjesën ku gadishulli bashkohet me pjesën tjetër të tokës gjendet një luginë e krijuar nga erozioni. Vija bregore e kësaj lugine është shkëmbore me plazhe të vogla në pjesët e zhveshura. Zona është përgjithësisht e zhveshur me prezencë të rrallë të shkurretave mesdhetare, kryesisht makie.

Klima

Zona në studim bën pjesë në nëndarjen klimatike mesdhetare paramalore. Veçoritë e klimës për zonën në studim kushtëzohen nga ndikimi i fuqishëm i detit Jon dhe barrierat orografike që e rrethojnë nga lindja e veriu dhe që e mbrojnë nga erërat e ftohta që vijnë nga brendësia e vendit. Temperatura mesatare vjetore është 17.0 °C, temperatura e janarit si muaji më i ftohtë është 10.3 °C dhe e korrikut si muaji më i nxehtë 24.8 °C. Karakteristikë për zonën në fjalë janë temperaturat relativisht të larta gjatë sezonit të dimrit.

Zona karakterizohet nga reshje atmosferike të konsiderueshme, të cilat shfaqen kryesisht në formë shiu. Bora është një dukuri e rrallë në zonë, përjashtuar lartësitë e mëdha si Vunoi. Regjimi i reshjeve atmosferike për zonën në studim është tipik i karakterit mesdhetar me maksimum në periudhën e dimrit dhe minimum gjatë periudhës së verës. Karakteristikë tjetër për regjimin e reshjeve në zonë është edhe intensiteti i madh i tyre. Sasitë deri në 100 mm për 24 orë janë dukuri e zakonshme, ndërkohë që ka raste që bien 300 mm e më shumë për të njëjtin interval kohe. Sasitë më të mëdha 24 orëshe vërehen në periudhën e vjeshtës për shkak të aktivitetit ciklonik në këtë periudhë. Erërat më karakteristike që ndeshen në zonën në studim janë briza dhe murlani.

Gjeologjia

Rajoni në studim ndërtohet nga depozitime që datojnë nga jurasiku e deri në kuaternar. Nga pikpamja litologjike zona në studim ndërtohet kryesisht nga formacione gëlqerore e terrigjene dhe më pak depozitime eluvialo-deluviale. Formacionet gëlqerore, të cilat përfaqësojnë edhe formacionin rrënjësor të zonës në studim, paraqiten masivë me ngjyrë të bardhë dhe gri dhe kanë aftësi të mira ujëmbajtëse. Formacionet terrigjene, ndërtohen nga depozitime flishore të ndërthurjes argjilo-alevrolito-ranore, ritëm mesëm deri ritëm trashë. Formacionet e kuaternarit, të cilat përfaqësojnë formacionin mbulesor të zonës,

ndërtohen nga depozitime eluviale dhe eluvialo–deluviale, të cilat janë formuar si rrjedhojë e shpërbërjes së formacionit flishor argjilo–alevrolito–ranor.

Hidrografia

Pasuritë ujore të rajonit në studim, ashtu si në të gjithë Bregun e Detit, janë të pakta dhe përfaqësohen gati krejtësisht nga burime karstike të llojeve të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre burimeve shfaqen në buzë të detit (burime bregdetare) ose nën det (burime nëndetare). Kjo lidhet me faktin që malet në këtë pjesë bien drejtpërdrejt mbi det, kështu që niveli bazë i ujrave nëntokësorë është deti. Burimet më të afërta ujore sipërfaqësore të zonës janë përroi i Kudhësit dhe më tej akoma lumi i Borshit.

Tokat

Tipi kryesor i tokave që takohet në zonën e propozuar për zbatimin e projektit është ai i Tokave të Hinjta Kafe. Ato janë karakteristike për kodrat dhe malet e ulta të zonës bregdetare dhe takohen në lartësitë 0-200 m mbi nivelin e detit. Tokat e Hinjta Kafe formohen në kushte të klimës mesdhetare fushore dhe kodrinore, mbi materiale primare me natyrë të ndryshme. Në sistemin kodrinor bregdetar të vendit, ku përfshihet edhe zona në studim, ato janë zhvilluar mbi depozitime proluviale dhe deluviale të formuara nga alterimi i gëlqerorëve. Njëkohësisht janë toka që zhvillohen në kushte të një relievi heterogjen. Tokat e Hinjta Kafe shfaqen me profil të diferencuar në shkallë të ndryshme.

BIODIVERSITETI

Flora

Të dhënat historike të mbledhura për rajonin bregdetar jugor të Shqipërisë tregojnë vlera të larta në biodiversitet, në habitate dhe shoqërime të bimëve. Vegjetacioni tokësor është i përbërë nga këta tipe kryesore:

- Vegjetacioni i rrafshnaltës ose pyjet e gjelbër dhe shkurret i cili shtrihet nga vija bregdetare deri në lartësinë 900 m. Në shpatet e kodrave takohet vegjetacioni i llojeve gjethegjera i përfaqësuar nga shoqërimet *Orno – Quercetum ilicis* etj. ndërsa në lugina ndeshet vegjetacioni i makjes.
- Tip tjetër vegjetacioni që takohet në lartësitë 50-100 m është ai që dominohet nga shoqërime bimore të *Euphorbia dendroides* dhe *Pistacia lentiscus –Allianca Oleo – Ceratonion*. Vegjetacioni i tipit të shkurretave me gjatësi fizike jo më shumë se 100 cm i përfaqësuar nga shoqërime të *Chrysopogono – Phlometum fruticosae*, *Assoc. Ericetum manipuliflorae* etj. Ky vegjetacion është gjërësisht i përhapur në tokat e cekta bregdetare dhe formacionet gëlqerore.
- Vegjetacioni i pseudo–stepës dominuar nga *Brachypodium ramosum*, formimi i të cilit është shkaktuar nga mbikullotja. Ky lloj vegjetacioni është prezent në fushëgroën e Borshit.

Fauna

- Herpetofauna - Në zonën në studim takohen rreth 11 specie amfibësh (nga 15 specie që ka gjithë vendi) dhe 30 specie reptilësh (nga 37 që ka gjithë vendi). Herpetofauna mjaft e pasur dhe e shumëllojshme shpjegohet me pozicionin gjeografik të zonës, kushteve të favorshme klimatike dhe tipeve të ndryshme të habitateve.
- Avifauna - Nga 330 lloje që vrojtohen në të gjithë vendin, në zonën në studim takohen rreth 250 specie zogjsh, si detarë, ashtu edhe ata të pyllit.
- Mamalofauna – Bazuar në të dhënat mbi prezencën e gjitarëve në bregdetin jugor të Shqipërisë, mendohet se në zonën në studim takohen rreth 55 specie nga 77 që ka gjithsej vendi ynë.
- Njëkohësisht zona dallohet për një numër të madh specimesh të invertebrorëve. Në të janë vrojtuar rreth 151 specie të rendit *Coleoptera* dhe 93 specie të rendit *Lepidoptera*.

Mjedisi detar

Të dhënat për florën dhe faunën detare të zonës evidentojnë rreth 131 lloje algash makrofite, 251 llojesh peshqish, 104 lloje dekapodësh dhe 84 lloje moluskësh. Prezenca në këto ujëra e llojeve të rralla të peshqve si *Luvarus imperialis*, *Ranzania laevis*, *Coelorrhinchus coelorrhinchus*, *Lebistes reticulatus*, venë

në pah vlerat dhe pasuritë unike të ujrave të Jonit. Habitata të rëndësishme për peshqit konsiderohen edhe livadhet e *Posidonia sp.* në thellësitë e 4- 5 m. Këto livadhe janë tepër të rëndësishme për ushqimin e strehimin e një numri të madh llojesh, përfshi peshqit, krustacet dhe invertebrorëvt. Zona e mediolitoralit përfaqësohet nga cilësia e ujrave dhe prezenca e *Coralligenous algae* të përbëra nga *Lithophyllum sp.* që shtrihen përtej thellësisë vertikale më shumë se 1 m. Zona e infralitoralit shtrihet lokalisht në zonën e mbi 45 m thellësi. Infralitorali përbëhet kryesisht nga *Cystoseira sp.* me *Padina sp.*, *Acetabularia sp.*, *Cymadocea sp.* mbi të cilat ushqehen lloje peshkore si *Sarpa salpa* etj. Zona e propozuar për zhvillimin e projektit është më e mira për rritjen e peshkut në të gjithë Bregun e Detit.

Cilësia e ujërave bregdetarë

Zona e propozuar për zhvillimin e projektit gjendet ndërmjet plazhit të Himarës dhe atij të Borshit. Për zonën në fjalë nuk ka të dhëna mbi cilësinë e ujërave bregdetarë pasi nuk përfshihet në stacionet e monitorimit, por mund të përdoren të dhënat e përfuara nga monitorimet e kryera në plazhet e Himarës dhe Borshit. Referuar Raportit të gjendjes në mjedis 2015, hartuar nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit, të dy këta plazhe cilësohen si të kategorisë A. Për rrjedhojë edhe ujërat e zonës ku do të zhvillohet aktiviteti janë të kategorisë A, me cilësi të shkëlqyer.

Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës

Zona e propozuar për zhvillimin e projektit nuk ndërpret asnjë prej zonave të mbrojtura të vendit tonë. Njëkohësisht ajo nuk ka pikëprekje as me ndonjë nga monumentet e natyrës të rrethit të Sarandës, shpallur të tilla me VKM nr. 676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”.

VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS TË INSTALIMIT

Metodika e vlerësimit të ndikimeve

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur për zhvillimin e saj, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Është e rëndësishme të kuptohet natyra e proceseve të punës dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve. Të gjitha ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis në fazën e instalimit të impiantit

Nga analiza që i është bërë në kapitujt e mëparshëm veçorive të zonës ku propozohet të zhvillohet aktiviteti, vërehet se ajo paraqitet me parametra të kënaqshëm mjedisorë, të cilët lejojnë veprimtari të kësaj natyre. Më konkretisht:

- zona (mjedisi tokësor dhe ai detar) nuk vlerësohet e ndotur,
- në të nuk ekziston presioni i ndotjes pasi rrotull saj nuk ka zhvillim të industrive.

Njëkohësisht ajo ndodhet larg qendrave të banuara duke iu shmangur kështu edhe presionit nga ndotja urbane,

- zona ka akses të drejtpërdrejtë me rrugën kombëtare duke mos patur nevojë për infrastrukturë shtesë,
- në afërsi të saj zhvillohen aktivitete të njëjta pasi siç është treguar në paragrafët e mësipërm, Gjiri i Palermos përfaqëson zonën më të mirë në të gjithë bregdetin jonian për rritjen e peshkut.

Identifikimi i ndikimeve negative gjatë zhvillimit të aktivitetit

Pjesë e aktivitetit të kultivimit artificial të peshkut janë operacione të tilla si ushqimi, vaksinimi etj. Nga mosnjohja dhe mosmenaxhimi i drejtë i këtyre proceseve mund të shfaqen pasoja të tilla si akumulime të lëndës ushqyese, feçes etj.

Ndikimet në mjedis nga ushqimi

Dy lloj ndikimesh mjedisore rrjedhin nga ushqimi:

- lënda solide: suspendet, feçet, lënda organike me përmbajtje fosfori dhe azoti;
- materia e tretshme: azoti i tretur dhe fosfori që derivon nga metabolizmi i peshkut dhe lënda ushqyese dhe feçet.

Vaksinimi dhe përdorimi i medikamenteve

Procesi i zhvillimit të akuakulturës përfshin edhe vaksinimin dhe përdorimin e medikamenteve të ndryshme, veprime që shoqërohen gjithashtu me ndikime në cilësinë e ujrave detarë. Ndikime të tjera të mundshme në këtë fazë janë ndotjet nga substancat disinfektante të strukturave.

MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Me qëllim që të parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore të projektit si gjatë fazës së instalimit të impiantit ashtu edhe gjatë zhvillimit të aktivitetit, shoqëria duhet të marrë masat e duhura për mbrojtjen e mjedisit. Këto masa janë të karakterit *teknik* që nënkupton

përshtatjen e projektit me vlerat natyrore të zonës për t'i mbrojtur në maksimum ato, dhe të karakterit *organizativ*, i cili nënkupton hartimin e një plani menaxhimi mjedisor dhe zbatimin rigoroz të tij.

Masat zbutëse të ndikimeve në mjedis gjatë zhvillimit të aktivitetit

Shoqëria do t'i kushtojë kujdes të veçantë menaxhimit të specieve që do të kultivohen. Ajo do të importojë *rasat të çertifikuara* nga Italia, i cili plotëson të gjitha normat dhe standartet e BE. Njëkohësisht, do t'i kushtohet vëmendje e posaçme zbatimit të normave dhe standarteve që lidhen me;

1. sasinë e stokut dhe raportet;
2. peshën e tërheqjes/kohën e duhur;
3. vlerësimin e shkallës së mortalitetit (%/vit).

Në lidhje me minimizimin dhe mënjanimin e ndikimeve të mundshme negative në ujërat detarë nga *ushqimi*, kompania do të marrë këto masa:

1. përdorimi i ushqimi të çertifikuar i cili plotëson standartet e BE;
2. hartimi i një plani ushqyes eficient i cili do të përshtasë regjimin me fazën konkrete të rritjes;
3. optimizimi i formulës së ushqimit nëpërmjet,
 - përdorimit të ushqyesve me përmbajtje të ulët fosfori dhe azoti,
 - optimizimit të llojit të ushqimit,
 - optimizimit të regjimit dhe teknikave të të ushqyerit.

Për të minimizuar ndikimet e mundshme negative në ujërat detarë të *ushqimit dhe trajtimit me vakcina dhe medikamente*, shoqëria do të përdorë trajtues të ujrave (flokantë) të cilët ndihmojnë në uljen e turbiditetit. Si i tillë mund të përdoret gëlqerja e cila neutralizon edhe amoniakun.

Masa të tjera zbutëse gjatë fazave të ndryshme të rritjes së peshkut

- Përdorimi i llojeve optimale të ushqimit me formula të përshtatshme, me tretshmëri të lartë, madhësinë e duhur dhe në gjendje të thatë,
- Zbatimi i regjimeve eficientë të të ushqyerit si dhe teknikave bashkëkohore;
- Përdorimi i strukturave speciale përreth koshave si çantat e posaçme;
- Pastrimi i individëve të ngordhur në kosh.

- Ulja e shkallës së mortalitetit do të realizohet përmes kontrollit të vazhdueshëm të ujrave për ruajtjen e parametrave të kërkuar për rritjen e peshkut;
- Përdorimi i vaksinave dhe medikamenteve.

Ing PETRIT DERVISHI
EKSPERT
V.N.M e A.MJEDISOR
VLORE

